



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 2088 Prot

Vlorë, më 24.07.2017

VENDIM

Nr. 24, datë 20/07 /2017

PROPOZIM PËR SHPALLJE “ DËSHMOR I ATDHEUT”

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 20/07/2017 në zbatim të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjit Nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 151, datë 25.04.2002 Për Statusin “Dëshmor i Atdheut” (i ndryshuar), Udhëzimit Nr. 1803, datë 10.06.2002 Për zbatimin e V.K.M-së Nr.151, datë 25.04.2002 për Statusin “Dëshmor i Atdheut” si dhe Vendimeve Nr.01, Nr.02, Nr.03 datë 10.07.2017 të Komisionit për Statusin e “Dëshmorit të Atdheut“ pranë Këshillit të Qarkut Vlorë;

VENDOSI;

1.Ti propozoj Komisionit Qëndror të Statusit “Dëshmorit i Atdheut“, shpalljen “Dëshmor të Atdheut“ të personave të mëposhtëm:

Zotit Fatmir Hito MËHILLI i datëlindjes 06.08.1958, ish ushtarak aktiv, Komisar i Kompanisë, oficer në Repartin Ushtarak 4011 (Porto Palermo) Himarë, i cili gjatë kryerjes së detyrës më datë 26 shkurt 1986 është vrarë nga një ushtar i SHDUA- së.

Zotit Thoma Stavro ÇAKULI i datëlindjes 11.04.1949, ish ushtarak aktiv, Komisar Batalioni në Repartin 9727, Shelegar Sarandë, i cili gjatë kryerjes së detyrës më datë 13 qershor 1987 është vrarë nga një ushtar i SHDUA-së.

Zotit Petrit Nebi JAHAJ i datëlindjes 06.10.1957, pjesë e ekuipazhit të rimorkiatorit “Iliria”, i cili u përfshi në operacionin e shpëtimit të pasagjerëve të tragetit “Norman Atlantik”, operacion në të cilin humbi jetën më datë 30 dhjetor 2014.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Ervis MOCKA



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. _____ Prot, datë 27 /2017.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi “ 4 Heronjtë ”, Vlorë

Web site: www.qarkavlore.gov.al
E-mail: info@qarkavlore.gov.al